



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 464/01-16869
Dt: 08.04.2026

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 të ligji nr. 03/l-040 për vetëqeverisjen lokale (G. Zyrtare nr. 28/2008 të dt. 04.06.2008), nenin 4, nenin 7, nenin 8, paragrafi 5 të ligjit nr.03/l-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (G. Zyrtare nr. 52/2009 të dt. 08.05.2009), me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 03/l-205 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/l-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme (G. Zyrtare nr. 91/2010 dt.10.12.2010) dhe nenin 44 të ligjit nr. 05/l-031 për procedurën e përgjithshme administrative (G, Zyrtare nr. 20/2016 të dt. 21.06.2016), me dt. 08.04.2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** kërkesa për shpronësimin për interesin publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit, të cilat ndodhen në zonën kadastrale: Gjakovë Jashtë Qytet, me nr. Parcelave 5287-18, 5287-13, 5287-5, 5287-2 dhe 5287-19, të cilat preken nga projekti “Ndërtimi i Qarkores, Vazhdimi i Rrugës Bujar Roka”, sipas tabelarit i cili i është bashkangjitur këtij Vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave përcaktohet nga Zyra për vlerësimin e pronës së paluajtshme/Ministria e Financave, Punës dhe Transferova të Republikës së Kosovës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e Komunës së Gjakovës.
4. Vendimi hynë në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës së Gjakovës
- Drejtorisë për Infrastrukturë
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL GJAKOVË
SKUPSTINA OPSTINE GJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. Pikes	Nr. parcelles	Pronari	Sipërfaqja[m ²]	Kultura	Sipërfaqja për shpronësim[m ²]	sipërfaqja e mbetur[m ²]	Përshtkrimi	Zona kadastrale
1	5287-18	1/1 Ndrecaj Luz(Gjergj-Qirambajtë 96 vite, 7 muaj, 27 ditë.	2000	Kullosel(1)	84	1916	Pa Investime, trotuar është realizuar nga Komuna e Gjakovës	Gjakove Jashte Qytet
2	5287-13	1/1 Curaj-Qirambajtë për 96 vite, 7 muaj, 21 ditë Dulavere(Vesel)	3650	Kullosel(1)	101	3549	Pa Investime, trotuar është realizuar nga Komuna e Gjakovës	Gjakove Jashte Qytet
3	5287-5	1/1 Lazri Sokol (Pal)	813	Oborr, Shtëpi, Kullosel(1)	18	795	Trotuar i shtuar me kubëza në sipërfaqe prej 18m ²	Gjakove Jashte Qytet
4	5287-2	1/1 Ueshi korab(Flanur)	889	Jopjellore	58	831	Trotuar i shtuar me kubëza në sipërfaqe prej 58m ²	Gjakove Jashte Qytet
5	5287-19	1/1 Ueshi Burim (Aziz) - Qirambajtë 96 vite, 7 muaj, 21 ditë.	555	Kullosel(1)	555	0	Pa Investime, asfalti është realizuar nga Komuna e Gjakovës	Gjakove Jashte Qytet

